



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 12.1, 12.2 shkronja d) dhe 40.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, neneve 15.1, 15.2 shkronja d) dhe 34.2 shkronja d) të Statutit të Komunës nr.01-1/298-10 të datës 12 tetor 2009, dhe nenit 87.1 të Rregullores së punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës, nr.01/146-11 të datës 29 prill 2010, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2018, miratoi,

VENDIM PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2018

Neni 1

Miratohet Plani i Punës i Kuvendit të Komunës së Podujevës për pjesën e mbetur të vitit 2018

Neni 2

Kuvendi i Komunës përveç pikave të parapara me këtë plan shqyrton edhe çështje tjera sipas nevojës, mban edhe mbledhje tjera varësisht nevojave dhe kërkesave të paraqitura për shqyrtim dhe miratim.

Neni 3

Plani i punës, në formë tabelore, dhe temat tjera shtesë janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 8.11 të Rregullores (QRK) nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Nr. 01-016/01-0014927/18
Podujevë,
28 shkurt 2018



Plani i Punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2018

Muaji	Pikat e parapara për rendi dite
Janar	
Shkurt	
Mars	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti Financiar për vitin 2017 • Themelimi i Këshillit Komuna për Siguri në Bashkësi • Plani i Veprimit për Transparencë për vitin 2018 • Propozimi i Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve (vënia në diskutim Publik) • Propozimi i vendimit për Bartjen e të hyrave vetanake nga viti 2017 në vitin 2018 dhe destinimin e tyre në kategori të caktuara buxhetore
Prill	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti Financiar tremujor, periudha janar-mars 2018 • Çështje të ndryshme të cilat paraqiten sipas nevojës •
Maj	<ul style="list-style-type: none"> • Informatë rreth gjendjes së Shëndetësisë në Komunën e Podujevës •
Qershor	<ul style="list-style-type: none"> • Korniza Afatmesme Buxhetore - KAB 2019/2021 • Rishikimi i Buxhetit për vitin 2018 •
Korrik	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti Financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit, periudha janar – Qershor 2018 • Informatë për përfundimin e vitit shkollorë 2017/2018 •
Gusht	<p>Pushim, Përveç nëse paraqitet nevoja për shqyrtim dhe miratim të ndonjë çështjeje urgjente ose të jashtëzakonshme</p>
Shtator	<ul style="list-style-type: none"> • Miratimi i projektbuxhetit për vitin 2019 dhe projekteve prioritare për vitet 2020 – 2021 • Miratimi i Rregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2019 • Informatë për përgatitjet e fillimit të ri shkollorë 2018 – 2019 • Informatë e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për përfundimin e korrje – shirjeve dhe përgatitjet për mbjellje vjeshtore •
Tetor	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti Financiar nëntëmujor, periudha janar – shtator 2018
Nëntor	<ul style="list-style-type: none"> • Ngritja e Grupit punues për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2019
Dhjetor	<ul style="list-style-type: none"> • Raporti i punës së Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve të Përhershme për vitin 2018 • Plani i punës i Kuvendit të Komunës për vitin 2019

Propozimet tjera të miratuara për përfshirje në kuadër të Planit të punës, por pa caktuar muajin, janë:

- Propozim Statuti për plotësimin dhe ndryshimin e Statutit të Komunës
- Plani i Prokurimit për vitin 2018
- Propozim nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, për ndarjen e subvencioneve për klubet sportive
- Plani i punës për Ekzekutivin – raportim i drejtorëve të Drejtorive
- Informatë nga Drejtoria e Inspeksionit, lidhur me inspektimin e bizneseve në territorin e Komunës së Podujevës
- Informatë për gjendjen e Pyjeve në territorin e Komunës së Podujevës
- Informatë për ndarjen e Bursave për vitin 2018